



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Auditimi Menaxherial
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Obliguese
Viti i studimeve:	2
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Fakulteti I biznesit , Peje
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrim i lëndës	Kursi Auditimi Menaxherial trajton tri fusha kryesore: I) Auditimin e Menaxhmentit, II) Kontrollin dhe Auditimin e Brendshëm, dhe III) Auditimin e Forenzikës Ligjore. Kjo lëndë mbulon çështjet bashkëkohore në auditimin e menaxhimit, duke përfshirë kontabilitetin dhe raportimin e kostos, vlerësimin e kontrollit të brendshëm dhe rolin e CMA-ve. Për më tepër, ofron një pasqyrë të teknikave të auditimit forenzik dhe standardeve ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs ka për qëllim të ofrojë studentëve konceptet dhe metodat kryesore të auditimit menaxherial, duke përfshirë vlerësimin e performancës, identifikimin e rreziqeve, dhe përmirësimin e proceseve menaxheriale.
Rezultatet e pritura të nxënies:	• Udhëzon auditimet e menaxhimit dhe identifikojnë mangësitë funksionale. • Drejton auditimet e sistemit të informacionit, zbulimin dhe adresimin e kërcënimeve. • Kontrolli i Brendshëm, Auditimi i Brendshëm dhe Auditimi Operacional. • Siguroni përputhshmërinë rregullatore dhe udhëzoni vlerësimet e kontrollit të brendshëm. • Zhvillimi i aftësive për vlerësimin e gjithanshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm. • Përgatitja e programeve të detajuara të auditimit të industrisë. • Kontrolli i forenzikës Ligjore dhe Kundër Pastrimit të Parave. • Identifikoni mashtrimet financiare duke përdorur teknika të ndryshme. • Njohni mospërputhjen që çon në pastrim parash dhe udhëzoni masat parandaluese.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	7	7
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	8	2	16
Kolokviume, seminare	3	4	12
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	5	5
Përgatitja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	4	12
Projektet, prezantimet ,etj	1	8	8
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	- Mënyra e të mësuarit do të jetë përmes ligjëratave dhe ushtrimeve(me studime rasti dhe me punime seminarike do të realizohen ushtrimet). - Mësimi do të zhvillohet në grupe. Për çdo segment të një ligjëratë përgatitet prezantimi edhe në sllajde ku u prezantohet studentëve rregullat, principet themelore të njësisë mësimore. - Në çdo pjesë të ligjëratës përkatëse studentët aktivizohen me komente, pyetje dhe sqarime plotësuese si rezultat të pyetjeve. - Studentët kanë komoditet që të komentojnë, pyesin dhe të sqarojnë dilemat dhe pakjartësit eventuale, gjithnjë me një rend dhe disiplinë adekuate.		

	- Një ditë në javë, pra pas përfundimit të mësimit mbaj konsultime me studentët edhe pse studentët e gëzojnë të drejtën e komunikimit përmes postës elektronike.. - Në ushtrime, krahas zgjidhjes së detyrave nga lënda mësimore, do të zhvillohen diskutime për problemet e ndryshme financiare globale, rajonale apo vendore si dhe zgjidhja e këtyre problemeve.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi përbëhet nga pjesa e provimit me shkrim dhe me gojë. Vlerësimi po ashtu bazohet në këto aktivitete: - Pjesëmarrja dhe angazhimi në orë (10%) (Koll.) Testi 1 - 40 % (Koll.) Testi 2 - 40 % - Punimet seminarike (puna e pavarur individuale) - 10%. - Provimi përfundimtar: 80 % (për ata që nuk i kalojnë kollokviumet). Llogaritja e notave: Shembull: Në rast se student X ka fituar: 50 pikë ne Testin 1, 70 pikë në Testin 2 10%=10 pikë ,vijueshmëria 10%=10 pikë, puna e pavarur individuale atëherë:
Literatura	
Literatura bazë:	<i>Parimet e Auditimit dhe Shërbimeve Tjera të Sigurisë</i>, edicioni i 17-të nga Ray Whittington dhe Kurt Pany New York, NY: McGraw-Hill/Irwin, 2010 - Bedri Statovci, Shefket JAKUPI, Auditimi i Avancuar ,Pejë ,2017 - Auditing Management, The Institute of Cost Accountants of India CMA Bhawan, 2022 - Auditing Management, Julie Ann Gardner Treloar, 2012
Literatura shtesë:	- William F. Messier Jr, DBA, CPA, Auditing, McGRAW HILL, INC, (anglisht-kroatisht), Zagreb 2007 - Rich Hayes, Arnold Schilder, Roger Dassen, Philip Wallage, Principals of Auditing, Concepts and methods McGraw-Hill, INC (anglisht-kroatisht) Zagreb 2006 - Vjollca Karrapici „AUDITIM“ Tiranë 2011
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantimi i syllabuesit - Hyrje në auditim
Java e dytë:	Auditimi si profesion dhe edukim - Profesioni i auditorit të jashtëm - Kriza e besueshmërisë në profesionin e auditimit - Llojet e auditimeve - Llojet e auditorëve - Provimi për auditorë (SHBA/Evropë/ Kosovë)

	• Llojet tjera të shërbimeve profesionale të Auditorit • Organizimi i profesionit të auditimit • Specializimi në industri të caktuar • Përgjegjësit e stafit profesional • Zhvillimi profesional për personelin e kompanive audituese • Lëkundjet sezonale në punën e auditimit Literatura: Libri - Parimet e Auditimit dhe Shërbimeve Tjera të Sigurisë fq. 10-27
Java e tretë:	Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe Auditimit • Standardet profesionale • Standardet e auditimit për kompanitë publike dhe jo-publike • Standardet e përgjithshme • Standardet e punës në terren • Standardet e raportimit • Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit • Ligji për raportim financiar, kontabilitet dhe auditim në Kosovë ligji nr 06/L-032 Literatura: Libri - Parimet e Auditimit dhe Shërbimeve Tjera të Sigurisë fq. 34-43 Ligji për raportim financiar, kontabilitet dhe auditim në Kosovë ligji nr 06/L-032
Java e katërt:	Etika Profesionale • Etika profesionale në profesionin e auditimit • Kodi i sjelles profesionale i AICPA-së • Korniza për sjellje etike • Parimet e etikes profesionale • Fushat të cilat ndikojnë në sjelljen etike • Perfitimet nga sjella etike • Mashtrimet në kontabilitet dhe auditim – rasi i Enron dhe Worldcom Literatura: Libri - Parimet e Auditimit dhe Shërbimeve Tjera të Sigurisë fq. 75-113
Java pestë:	Bazat e Auditimit të Menaxhmentit • Çështjet dhe analizat e raportimit të menaxhmentit
Java gjashtë	Planifikimi i auditimit, njohja e klientit, vlerësimi dhe reagimi ndaj rreziqeve • Procesi i auditimit • Përzgjedhja e klientëve • Parashtrimi i kërkesës për auditim • Komunikimi me auditorët paraardhës • Planifikimi i auditimit • Zhvillimi i strategjisë së përgjithshme të auditimit dhe plani i auditimit • Njohja e klientit dhe e rrethinës në të cilën ai vepron • Procedurat për vlerësimin e rrezikut

	Literatura: Libri - Parimet e Auditimit dhe Shërbimeve Tjera të Sigurisë fq. 197-237
Java e Shtatë	Kolokviumi i parë
	Kontrolli i brendshëm • Kuptimi i kontrollit të brendshëm • Akti i praktikave të huaja korruptive i vitit 1977
Java e tetë	Mënyrat e realizimit të kontrollit të brendshëm • Mjedisi i kontrollit • Bordi i drejtorëve ose komiteti i auditorëve • Filozofia e menaxhmentit dhe mënyra e të operuarit • Auditimet e pasqyrave financiar: roli i kontrolleve të brendshme Literatura: Libri - Parimet e Auditimit dhe Shërbimeve Tjera të Sigurisë fq. 264-317
Java e nëntë:	Marrja në konsideratë e kontrolleve të brendshme në një mjedis të teknologjisë informative (TI) • Natyra e sistemeve të bazuara në TI • Karakteristikat e llojeve të ndryshme të sistemeve të bazuara në TI • Ndikimi i TI-së në evidencën e auditimit • Kontrolli i brendshëm në një mjedis të TI-së • Dizajnimi i procedurave thelbësore përmes kompjuterëve Literatura: Libri - Parimet e Auditimit dhe Shërbimeve Tjera të Sigurisë fq. 318-356
Java e dhjetë:	Kontrolli forenzik • Kundër pastrimit të parave
Java e njëmbëdhjetë:	Vlerësimi i rrezikut dhe materialiteti • Njohja mbi rrezikun • Procedurat e vlerësimit të rrezikut • Lidhshmëria e reziqeve të auditimit • Rreziku inherent (vetëvetishëm) • Kontrolli i rrezikut dhe rreziku i moszbulimit • Rreziku alfa dhe beta • Materialiteti • Vlerësimi i rrezikut të anomalive material • Përgjigja ndaj vlerësimit të rrezikut • Informacionet tjera që ju kërkohen auditorëve për materialitetin • Mashtrimet, ligjet dhe rregulloret e kontabilitetit • Raste studimore – punë e pavarur • Pyetje për diskutim Literatura: Libri - Auditimi i avancuar, Pejë, f.237-260
Java e dymbëdhjetë:	Raporti i Auditorit - Elementet • Raporti i auditorit – Elementet • Elementet themelore të raportit të auditorit • Raporti pa rezervë i auditorit • Raportet e modifikuara • Çështjet të cilat nuk ndikojnë në opinionin e auditorit • Çështjet të cilat ndikojnë në opinionin e auditorit

	• Përmbledhje e llojeve të opinionit • Anomalitë materiale për fakte të raportuara • Raste studimore – punë e pavarur • Pyetje për diskutim Literatura: Libri - Auditimi i avancuar,Pejë, f.261-287
Java e trembëdhjetë:	Përpilim i raportit të auditorit në praktikë • Përpilimi i raportit dhe pjesët e raportit • Dhënia e mendimit nga ana e auditorit • Raste studimore – punë e pavarur • Pyetje për diskutim Literatura: Libri - Auditimi i avancuar,Pejë, f.341-360
Java e katërbëdhjetë:	Diskutime/Seminare /Prezantime
Java e pesëmbëdhjetë:	Kolokviumi i Dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshetrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutim e lidhur me to. Student i duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe të punimit.